



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

---

Numri i lëndës: 2021:107008

Datë: 19.04.2024

Numri i dokumentit: 05596944

**PA1.nr.861/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Mehmet Ndrecaj, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit akuzuarit M.N nga fshati ..., Komuna e Gjilanit për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të Kodit Penal të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit M.N av. A.I të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.402/21 të dt.19.04.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 05.03.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Aprovohet** si e bazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit M.N av. A.I, **Ndryshohet** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Penal, P.nr.402/21 të dt.19.04.2023, ashtu që i akuzuari M.N, në pajtim me nenin 363 par. 1 nënpar. 1.1 të KPPRK-së:

**LIROHET NGA AKUZA**

Se me datën 07.09.2018, në kohë të papërcaktuar, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, e ka vënë në lajthim të dëmtuarin A.A, ashtu që ka lidhur ofertën me shkrim –vetëm puna, për t ndërtuar një stallë për kultivimin e kafshëve qumështore, e me të cilën janë pajtuar dhe ka filluar ekzekutimi i punëve, mirëpo, pasi që tereni ka enë i pjerrët, i dëmtuari është dashur që të punojë punime shtesë, jashtë ofertës, për çka, edhe i akuzuari është pajtuar dhe i ka premtuar që do ta paguajë edhe për punën shtesë, jashtë ofertës, por, pas përfundimit të punëve, i akuzuari një pjesë ia ka paguar, në shumën prej 10.500 €, ndërsa, për punën shtesë,

shumën prej 3176.46 € nuk ia ka paguar, duke e mbajtur të dëmtuarin në lajthim dhe premtim të vazhdueshëm dhe duke i fshehur faktet se do ta kryejë pagesën, mirëpo, prej asaj kohe e deri më tani pagesën nuk e ka kryer, në këtë mënyrë, të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 3176.46 €,

-me çka kishte për të kryer veprën penale, Mashtrimi, nga neni 323 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës biejnë në barrë të mjeteve buxhetore.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Gjiilan, me aktgjykimin, P.nr.402/21 të dt.19.04.2023, të akuzuarin M.N e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Mashtrimi nga neni 323 par.1 të Kodit Penal të Kosovës dhe i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro dhe dënim me burg në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh. Në mbështetje të nenit 44 të KPRK-së , me pëlqimin e të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij, dënimi i shqiptuar me burg do ti zëvendësohet me dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro , të cilin dënim i akuzuari është i obliguar ta paguaj në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit. Në pajtim me nenin 76 par.2 nënpar.2.4 të KPRK-së, të akuzuarit i shqiptohet dënim unik me gjobë, në shumën prej 1000 (njëmijë) euro, ndërsa i akuzuari dënimin e zëvendësuar nga dënimi me burg në dënim me gjobë obligohet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, në të kundërtën vendimi mbi zëvendësimin e dënimit me burg me dënim me gjobë revokohet dhe i akuzuari do të filloj ta vuaj dënimin me burg sipas dispozitave në fuqi. Obligohet i akuzuari që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 20 (njëzetë) euro si dhe shumën prej 30 (tridhjetë) euro për kompensimin e viktimave të krimit , si dhe shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, nga dita pasuese kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. I dëmtuari, A.A , për realizimin e kërkesës pasurore juridike është udhëzuar në kontest të rregullt juridiko civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Mbrojtësi i të akuzuarit M.N av. A.I, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotët të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë dhe ta liroj nga akuza të pandehurin ose ta anuloj këtë aktgjykim dhe çështjen ta kthej për rigjykim dhe rivendosje.

Prokurori i Apelit, me parashtresën me shkrim PPA/II.nr.896/23 të datës 13.07.2023, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit caktoi dhe mbajti seancën e kolegjit, konform dispozitës së nenit 390 të KPP-së në të cilën prezantoi i akuzuari M.N dhe mbrojtësi i të akuzuarit, av. A.A. Prokuroria e Apelit, si dhe i dëmtuari, ndonëse të njoftuar me kohë dhe në mënyrë të rregullt nuk prezantuan

në seancë. Mbrojtësi i të akuzuarit M.N av. A.I deklaroi se mbetet në tërësi pranë pretendimeve ankimore të paraqitura në ankesën e parashtruar brenda afatit ligjor dhe propozimit si në ankesë duke konsideruar se nuk ka bazë juridike për shpalljen fajtor. I akuzuari, M.N deklaroi se e mbështet avokatin e tij mbrojtës dhe mbetet në tërësi pranë ankesës dhe propozimit si në ankesë dhe shton se ndihet i pafajshëm

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

### **-Ankesa është e bazuar.**

Mbrojtësi i të akuzuarit, M.N av. A.I e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotët të gjendjes faktike, me pretendimet se ky aktgjykim është marrë ,e shkelje esenciale të dispozitave të Procedurës Penale , për faktin se gjykata nuk ka arsyetuar në asnjë moment arsyet konkrete që kanë çuar gjykatën të marrë një aktgjykim fajësues për të pandehurin M.N , e që është obligim ligjor i gjykatës që për çdo pikë të dispozitivit të akteve të saja të jap arsyet konkrete dhe të sqarojë me saktësi të plotë se pse ka vendosur ashtu, në rastin konkret fare nuk ka arsyetuar dhe si të tillë këtë aktgjykim e bën të pakuptueshëm respektivisht dispozitivin dhe arsyetimin e tij ngase askund nuk janë dhënë vlerësimet e duhura ligjore nga ana e gjykatës e sidomos në pjesën e arsyetimit të gjykatës ‘Konstatimet e Gjykatës’.Një fakt tjetër që e bën të pa arsyeshëm këtë aktgjykim është edhe ajo që në këtë çështje së pari është raporti juridiko civil që i pandehuri dhe i dëmtuari kanë pasur , vërehet qartë se kemi të bëjmë me një kontratë mbi veprën dhe në rastin e tillë secila palë ka marrë rrishtun e vet për kryerjen e punëve, në këtë rast i dëmtuari A.A duke u bazuar në projektin e ndërtimit të stallës ka dhënë ofertën e tij , dhe është e natyrshme që hapja e themelit -heqja e dheut ,ndërtimi janë pjesë e çdo projekti sepse nuk mundet që një objekt të ndërtohet pa themel e po ashtu terreni nuk është gjithnjë i rrafshët, përveç kësaj qysh nga fillimi i njëjti ka qenë i njoftuar me projektin e ndërtimit , i njëjti ka parë terrenin e ndërtimit, ka marrë pjesë në ndërtim dhe mbi të gjitha është më përvojë të gjatë në ndërtimtari. Po ashtu në seancën e dt. 23.02.2023, i dëmtuari A.A deklaroi se cilat punime duhet t’i kryej e ka vërejtur edhe para lidhjes së kontratës, nga vizita në terren, ndërsa në kontratë janë marrë vesh për të gjitha punimet e ndërtimit të stallës, ndërsa në deklarinimin e tij në prokurori me dt.28.05.2021 në faqen e dytë të deklaratës së tij, rreshtin e 9 dhe 10 të deklaratës së tij i njëjti shprehet se ‘‘ ndërsa në punë shtesë nuk jam marr vesh në fillim sepse unë nuk kam qenë në vendin e ngjarjes atëherë’’, pra kemi qartë një deklarinim kundërthënës dhe një tentim për të përfituar përmes dënimit të të pandehurit. Pastaj, po të kishte bërë punime shtesë për të cilat pretendon i njëjti përse ka pritur kaq gjatë dhe nuk ka paraqitur më herët padi civile sipas bazës nga marrëdhëniet e detyrimeve (gjerimi i punëve të huaja pa porosi). Konsideron se ka të bëjë me një aktakuzë e cila të akuzuarin e ngarkon me veprën penale të mashtrimit, mirëpo në vete nuk përmban as edhe një provë për të vërtetuar pretendimet e shprehura në të, andaj propozon që Gjykata e Apelit të Kosovës ta aprovoj ankesën dhe ta ndryshoj aktgjykimin e shkallës së parë

dhe ta liroj nga akuza të pandehurin ose ta anuloj këtë aktgjykim dhe çështjen ta kthej për rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës vlerëson që pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit janë të bazuara. Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka ardhur në përfundim se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 paragrafi 2, nën-paragrafi 2.7 të KPPRK-së lidhur me par. 369 nënpar. 7 të KPPRK-së, si dhe me vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, nga neni 386 paragrafët 1 dhe 2 të KPPRK. Kjo pasi që në arsyetimin e aktgjykimit në fjalë nuk janë paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë arsye bindëse mbi bazën e së cilave do të mund të konkludohej se vepra penale me të cilën akuzohet i akuzuari përbënë vepër penale, ndërsa përfundimi i gjykatës së shkallës së parë se i akuzuari në fjalë është kryes i veprës penale për të cilën është shpallur fajtor është bazuar në një gjendje faktike të vërtetuar në mënyrë të gabuar. Në këtë drejtim, kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës konsideron që me provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor është vërtetuar se vepra me të cilën akuzohet i akuzuari nuk përbënë vepër penale, pasi që nga përshkrimi faktik përkatësisht nga veprimet kryese të cilat i vihen në barrë të akuzuarit me aktakuzë rezulton se në rastin konkret bëhet fjalë me raport civilo juridik. Nga aktgjykimi i ankimuar, por edhe nga shkresat tjera të lëndës rezulton se i akuzuari me të dëmtuarin A.A, ka lidhur ofertën me shkrim-vetëm puna, për të ndërtuar një stallë për kultivimin e kafshëve qumështore, e me të cilën janë pajtuar dhe ka filluar ekzekutimi i punëve, mirëpo, pasi që terreni ka enë i pjerrët, i dëmtuari është dashur që të punojë punime shtesë, jashtë ofertës, për çka, edhe i akuzuari është pajtuar dhe i ka premtuar që do ta paguajë edhe për punën shtesë, jashtë ofertës, por pas përfundimit të punëve, i akuzuari një pjesë ia ka paguar, në shumën prej 10.500 €, ndërsa, për punën shtesë, shumën prej 3176.46 € nuk ia ka paguar. Kolegji vlerëson se në rastin konkret kemi një marrëdhënieje civilo juridike të krijuar në mes të M.N dhe A.A për kryerjen e punëve ndërtimore ku gjatë realizimit të këtyre punëve punëkryesi në rastin konkret Ali Arifi është dashur që të kryej punë shtesë ndërsa i akuzuari ta paguaj për punën shtesë ku pas përfundimit të punëve, i akuzuari një pjesë ia ka paguar, në shumën prej 10.500 €, ndërsa, për punën shtesë, shumën prej 3176.46 € nuk ia ka paguar që nënkupton se i ka mbetur borxh pjesën e mbetur. Se në rastin konkret bëhet fjalë për raport civilo juridik vërtetohet edhe nga deklarata e vetë të dëmtuarit A.A i cili mes tjerash ka deklaruar se me të akuzuarin kanë kontraktuar ndërtimin e një stalle dhe meqë projekti ka qenë tipik për vend të rrafshët ndërsa vendi ku ka pasur për ta ndërtuar M ka qenë i pjerrët dhe i ngushtë dhe kanë pasur probleme për ta gjetur pozicionin sa më racional në mënyrë që kostoja të dalë sa më e ulët, ndërsa çmimi kontraktuar ka qenë në projekt por nuk i kujtohej vlera, për këtë i ka treguar M i cili i ka thënë bëja si të duash është në dorë tënde dhe se nuk do ti mbetet borxh asnjë cent, ky pastaj është munduar që ndërtimin t'ia përshtat vendit, për çka edhe janë marrë vesh që pagesa të jetë në vlerë 3176.46 euro, pa e llogaritur prashitjen e themeleve me dorë, por marrëveshje me shkrim nuk kanë bërë, pasi që M ka dhënë pëlqimin dhe është betuar se do ta bëjë pagesën e asaj pune shtesë....., e që sipas kolegjit penal të Gjykatës së Apelit nga të lartcekurat vërtetohet se në mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit ka pasur një raport kontraktual për kryerjen e punimeve ndërtimore, e që në rastin konkret bëhet fjalë për raport civilo juridik. Andaj edhe si rezultat i këtyre që u theksuar më lart, Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës ka vendosur që të aprovoj ankesën e mbrojtësit të akuzuarit, ndërsa ta ndryshoj aktgjykimin e ankimuar, në atë mënyrë që i akuzuari

të lirohet nga akuza për veprën penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, pasi që vepra me të cilën akuzohet nuk përbënë vepër penale por raport civilo juridik.

Meqenëse, i akuzuari është liruar nga akuza për shkak të veprës penale për të cilën i njëjti është shpallur fajtor, atëherë kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës duke u bazuar në nenin 453 paragrafi 1 të KPPRK-së, ka vendosur që shpenzimet e procedurës penale të paguhen nga mjetet buxhetore

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 par. 1 nënpar. 1.2 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.861/23, më datë 05.03.2024**

**Procesmbajtësja,**  
Gentijana Manaj-Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**  
Abdullah Ahmeti

---

Mehmet Ndrecaj

---